



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5, 15.1 dhe 21.2 të Ligjit për Aviacionin Civil Nr. 03/L-051,

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tej referuar si “Marrëveshja për HPEA”) në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes për HPEA për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës përfshirë edhe ato të lidhura në emër të saj nga UNMIK-u,

Duke pasur parasysh obligimin nga Marrëveshja për HPEA, që Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 104/2004 e 22 janarit 2004 e cila kërkon që rregullat për organizimin dhe përbërjen e Bordit të Apelit të Agjencisë Evropiane mbi Sigurinë e Aviacionit, të jetë pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 10/2010**  
**MBI RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN DHE PËRBËRJEN E BORDIT TË**  
**APELIMIT TË AGJENCISË EVROPIANE MBI SIGURINË E AVIACIONIT**

*Neni 1*

1.1 Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 104/2004 e 22 janarit 2004 mbi rregullat për organizimin dhe përbërjen e Bordit të Apelit të Agjencisë Evropiane mbi Sigurinë e Aviacionit (EASA), këtej e tutje referuar si Rregullore e Komisionit, shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 104/2004 i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe formon pjesën e saj përbërëse.

1.2 Dispozitat e neneve 1 deri 7 të Rregullores së Komisionit janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

1.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të Rregullores së Komisionit, të përfshirë në Shtojcën I të Marrëveshjes për HPEA, do të jenë të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

## *Neni 2*

Definicionet e termeve "Komuniteti", "ligji i Komunitetit", "legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aeroport i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Europiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", nëse referohen në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

## *Neni 3*

Në rast të ndryshimit të verzioneve të përkthyer në gjuhët shqipe dhe apo serbe me verzionin origjinal në gjuhën angleze të Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 1004/2004, versioni në gjuhën angleze siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian do të ketë përparësi.

## *Neni 4*

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 2010.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtor i Përgjithshëm